

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si autoriteti përgjegjës që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

Duke vlerësuar rëndësinë e zbatimit të mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut;

Duke mbajtur në konsideratë nevojën për forcimin e mekanizmave institucionalë të barazisë, mosdiskriminimit dhe mbrojtjes efektive të grupeve vulnerabël;

Duke vlerësuar rëndësinë e përafrimit të kuadrit ligjor dhe institucional për mosdiskriminimin me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe standardet evropiane për organet e barazisë;

Duke mbështetur bashkëpunimin e Komisionerit me institucionet publike në nivel qendror e vendor, shoqërinë civile, medien, publikun dhe partnerët ndërkombëtarë;

Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë vitit 2025, në këto drejtime:

Trajtimin e 424 çështjeve, nga të cilat 404 ankesa dhe 20 çështje *ex-officio*; dhënien e 284 vendimeve dhe 3 rekomandimeve; adresimin e 64 rekomandimeve ndaj institucioneve të tjera; si dhe dhënien e 8 rekomandimeve dhe opinioneve ligjore, me iniciativën e tij apo me kërkesë të institucioneve.

Kritjen e ndërgjegjësimit dhe raportimit të rasteve të diskriminimit, veçanërisht në fushën e të mirave dhe shërbimeve, punësimit dhe arsimit, duke evidentuar njëkohësisht sfida të vazhdueshme në garantimin efektiv të barazisë.

Trajtimin e çështjeve që lidhen me të drejtat e fëmijëve, gjuhën e urrejtjes dhe mbrojtjen e shtetasve të huaj, si fusha me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e grupeve në situatë vulnerabël dhe për përputhjen me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Ushtrimin e kompetencës për nisjen e çështjeve *ex officio*, si tregues i rolit proaktiv të Komisionerit në identifikimin dhe adresimin e rasteve të diskriminimit përtej ankesave individuale.

Dhënien e rekomandimeve dhe opinioneve ligjore për projektakte, përfshirë projektligje dhe projektvendime që lidhen me barazinë gjinore, vullnetarizmin, shërbimet, Avokatin e Popullit, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, Kodin Penal dhe draftin e Kodit të ri Penal.

Kuvendi i Shqipërisë rekomandon që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për vitin 2026:

1. Të përmirësojë raportimin vjetor, duke paraqitur të dhëna për numrin dhe tipologjinë e ankesave, bazat e diskriminimit, grupet e prekura, afatet e shqyrtimit, vendimmarrjet, masat administrative, zbatimin e rekomandimeve dhe rezultatet e ndërhyrjeve të institucionit, si dhe të publikojë informacionin me interes publik, në përmbushje të standardeve të Programit të Transparencës dhe të drejtës për informim.

2. Të forcojë rolin institucional në garantimin e mbrojtjes efektive nga diskriminimi, në përputhje me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe standardet evropiane për organet e barazisë.

3. Të rrisë eficiencën në trajtimin e ankesave, duke përmirësuar afatet, cilësinë dhe transparencën e procedurave administrative, me qëllim garantimin e një mbrojtjeje më efektive për qytetarët.

4. Të forcojë veprimtarinë monitoruese për përmirësimin dhe zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit, duke evidentuar problematikën e përsëritura dhe duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna ndaj institucioneve publike.

5. Të rrisë dhe të konsolidojë praktikën e shqyrtimit me vetiniciativë (*ex officio*) të çështjeve, si mekanizëm për identifikimin dhe adresimin e rasteve të diskriminimit, veçanërisht në rastet me karakter sistematik ose me ndikim mbi grupe vulnerabël.

6. Të forcojë bashkëpunimin me institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve për trajtimin efektiv të rasteve që lidhen me diskriminimin, gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes.

7. Të forcojë mekanizmat për identifikimin, raportimin dhe adresimin e diskriminimit, gjuhës së urrejtjes në mjedisin publik dhe *online*, veçanërisht ndaj grave dhe vajzave, personave LGBTI, fëmijëve, pakicave etnike, personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera vulnerabël, në përputhje me gjetjet e IBAR-it dhe rekomandimet e BE-së. Të nxisë edukimin digjital, mbrojtjen efektive të fëmijëve dhe koordinimin institucional për adresimin e diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes në hapësirën digjitale.

8. Të zhvillojë sistemin e mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave për diskriminimin, gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes, me qëllim krijimin e një baze për vlerësimin e situatës dhe orientimin e politikave publike.

9. Të rrisë ndërgjegjësimin publik për të drejtat në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, kompetencat e Komisionerit dhe procedurat e ankimit, përmes fushatave informuese dhe aktiviteteve edukative, me fokus të veçantë në zonat rurale, zonat e largëta, institucionet arsimore dhe komunitetet në nevojë.

10. Të kryejë sondazhe për diskriminimin sipas përcaktimeve të nenit 32, shkronja “e”, të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

11. Të kryejë një vlerësim të strukturuar për ndikimin e përdorimit të teknologjisë në ofrimin e shërbimeve publike bazë, përfshirë shërbimet arsimore, sociale dhe shërbime të tjera të domosdoshme, me qëllim evidentimin e pasojave diskriminuese ndaj shtresave në nevojë dhe personave në kushte vështirësie ekonomike dhe ta përcjellë këtë vlerësim pranë Kuvendit të Shqipërisë brenda muajit dhjetor 2026.

12. Të forcojë kapacitetet profesionale të punonjësve të Zyrës së Komisionerit përmes trajnimeve në fushën e diskriminimit të shumëfishtë, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, barazisë gjinore dhe mbrojtjes së grupeve vulnerabël.

13. Të forcojë bashkëpunimin ndërinstitutional me institucione të tjera, si: Avokatin e Popullit, AMA-n, KLSH-në dhe shoqërinë civile, si kusht për përmbushjen e standardeve të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, barazisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

14. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda tremujorit të tretë të vitit 2026.

15. Të sigurojë zbatimin në kohë të rekomandimeve dhe vendimeve të institucioneve të pavarura, duke raportuar periodikisht çdo katër muaj në Kuvend për masat e ndërmarra dhe statusin e zbatimit të tyre në përmbushje të detyrimeve institucionale, si dhe standardeve evropiane.

16. Të parashikojë në planifikimin buxhetor afatmesëm fondet e nevojshme për projektimin, ngritjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të integruar elektronik për menaxhimin e ankesave, administrimin e çështjeve, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve dhe raportimin institucional.

Miratuar në datën 2.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi